



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

Spitali Rajonal Durrës
Nr. Prot. 345
Datë 27.02.2025



Shtojcë e Marrëveshjes së përbashkët të datës 14.10.2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot më datë 18.02.2025, në qytetin e Tiranës midis palëve të mëposhtëme:

UNIVERSITETIT KATOLIK "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË", me seli në Tiranë
Rruga "Dritan Hoxha", përfaqësuar nga Rektori Prof. Leonardo Palombi,

në vijim do të quhet shkurt Universiteti,

DHE

SPITALIT RAJONAL TË DURRËSIT, me seli në Durrës Rruga "Aleksandër Goga",
përfaqësuar nga Drejtori Z. Ani Dyrmishi,

në vijim do të quhet shkurt Qendra Spitalore;

bihet dakort të nënshkruhet kjo shtesë e marrëveshjes me qëllim **"Për realizimin e programeve të studimeve të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë"** në bazë edhe të Marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Sh.T. Ministri i Shëndetësisë si dhe Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" të përfaqësuar nga Rektori.

Duke qenë se:

- nga 25.01.2017 mes Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe Spitalit Rajonal të Durrësit është nënshkruar marrëveshja për zhvillimin e aktivitetit praktik të specializantëve të këtij Universiteti, dhe rinovuar me datë 14.10.2022;
- nga viti akademik 2018 - 2019, pranë Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", janë aktive disa Programe të Specializimit Afatgjatë pas universitare në fusha të ndryshme të mjekësisë;
- duke marrë parasysh urdhrin e hapjes për Programet e Specializimeve Afatgjatë
- resurset e Qendrës Spitalore plotësojnë Standartet Shtetërore të Cilësisë, klinike dhe didaktike, për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë për sa i përket infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe kapacitetit didaktik dhe administrativë;

- Universiteti disponon autorizimin për aktivizimin e aktivitetit didaktik të Specializimeve Afatgjata në Fushën e Mjekësisë, në bazë të Vendimit të KM Nr.567, datë 27.08.2004 "Për Dhënien e Lejes për Hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe të Vendimit të KM Nr. 670, datë 28.09.2011 "Për Ndryshimin e Emërimit, nga Shkollë e Lartë Universitare, jopublike "Zoja e Këshillit të Mirë", në Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë";

Universiteti i përmbush "Standardet Shtetërore të Cilësisë" për akreditimin Institucional të Arsimit të Lartë, në bazë të Vendimit Nr. 136, datë 25.03.2016 "Për Akreditimin Institucional të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë". Universiteti përmbush kërkesat ligjore akademike në fuqi të parashkuara nga Ligji Nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në Vendimin e KM Nr. 424, datë 02.06.2010 "Për Miratimin e Rregullores për Sistemin e Akreditimit, Organizimin dhe Veprimtarinë e Institucioneve të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë" të ndryshuar;

Universiteti e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjin 10107, datë 30.03.2009 "Për kujdesin shëndetëror në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe Ligjin Nr. 10138, datë 11.05.2009 "Për shëndetin publik" i ndryshuar;

Universiteti realizon programe të përbashkëta të studimit të ciklit të dytë në fushën e Mjekësisë me Universitetin e Studimeve të Romës "Tor Vergata" në bazë të Marrëveshjes lidhur në datë 21.01.2005 dhe rinovimet në vazhdimësi dhe aktualisht në fuqi, duke lëshuar tituj të cilët, me të gjitha efektet juridike, konsiderohen të barazvlefshëm me titujt përkatës të lëshuar nga Fakulteti i Mjekësisë dhe Kirurgjisë së Universitetit të Studimeve të Romës "Tor Vergata" dhe bashkëpunimi mes dy universiteteve parashikohet të shtrihet dhe në didaktikën frontale dhe profesionalizuese të ciklit të tretë të studimeve duke ruajtur ky i fundit gjithësesi trajtën e programit shqiptar të studimit.

Përsa sipër bihet dakort midis palëve nënshkrimi i kësaj shtesë të marrëveshjes bazë, duke përbërë hyrja pjesë përbërëse të saj, sa vijon:

Art. 1

Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", si seli administrative e programeve të specializimeve, vë në dispozicion infrastrukturën përkatëse, burimet njerëzore dhe materiale, duke qenë e angazhuar në hapjen/aktivizimin e programeve të specializimit, akreditimin, koordinimin dhe ndjekjen e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve, procedurave të regjistrimit si dhe realizimin e procesit formues në të gjitha trajtat e tij.

Art. 2

Korpusi i profesorëve të Shkollës së Specializimeve është i përbërë nga personel akademik edhe personel i specializuar i qendrës spitalore, që plotëson standartet shtetërore të cilësisë dhe përzgjidhet në dakortësi me administratën spitalore nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi për pedagogje të jashtëm, sipas akteve ligjore në fuqi.

Art. 3

Me qëllim krijimin e profesionalizmit të nevojshëm për administratën, në fushat e ndryshme të programeve të specializimeve, universiteti mund të vërë në dispozicion edhe personelin e tij për të kontribuar në procesin formues të specializantëve pranë qendrave spitalore.

Art. 4

Spitali Rajonal i Durrësit merr përsipër në bashkëpunim me universitetin, vazhdimësinë e realizimit të Programeve të Studimeve të Specializimit Afatgjatë në Fushën e Mjekësisë duke ofruar disponibilitetin edhe për specialitetet si më poshtë:

1. Kirurgji Maksilo-Faciale
2. Kirurgji plastike, rikostruktive dhe estetike
3. Urologji
4. Otorinolaringoiatri

duke vënë në dispozicion infrastrukturën, konform Standartëve Shtetërore të Cilësisë për Specializimet Afatgjata në Fushën e Mjekësisë, si dhe personelin mjekësorë me kualifikimet e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, për realizimin e Tutorazhit Klinik sipas karakteristikave specifike të tabelës A bashkëlidhur Marrëveshjes.

Art. 5

Marrëveshja ka kohëzgjatje 5 vjecare nga data e nënshkrimit dhe është e ripërtëritshme në formë të shprehur. Palët mund të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga Marrëveshja me anë të një komunikimi të arsyetuar me shkrim, të dërguar 6 (gjashtë) muaj përpara afatit të skadencës, por duke u impenjuar në perfundimin e ciklit të plotë të studimeve që ka filluar në vitin akademik në të cilin është komunikuar tërheqja.

Mosrinovimi i kësaj marrëveshjeje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga pala e interesuar 6 (gjashtë) muaj përpara ndërprerjes së saj.

Art. 6

Çdo element tjetër i marrëveshjes bazë mbetet i pandryshuar.

Për Universitetin Katolik
"Zoja e Këshillit të Mirë"
Prof. Leonardo Palombi



Për Spitalin Rajonal
Durrës
Z. Ani Dymaishi

